# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-465861**
VERSIONI 2

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | "Agasi është mafiozi më i rrezikshëm i Evropës"/ Berisha: Vlora Hyseni ka zbatuar çdo porosi dhe urdhër të Ramës |
| ADRESA | `https://dosja.al/politike/agasi-eshte-mafiozi-me-i-rrezikshem-i-evropes-berisha-vlora-hyseni-ka-z-i515807` |
| BURIMI | dosja.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 24 shtator 2026, 12:04:28 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 24 shtator 2026, 11:55:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `0a8b48b2d7745aac0b9d1ecb25492f26e776007732bb52ab412c03f6872a80e2` |
| TEKSTI | `c007eac87be2f92aa314065cf8f03028a75758110dca90865103a844d12361c8` |
| PAMJA | `c6c9a1805ff59ce4ac58a8728537917bfff0c0aad3fd8aa7ad96b70d8cb2960f` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `0bb830ded3333b62dba7479bf422d34fcd1ed66c58d00d68558eb6f15262fca6` |
| E MËPARSHMJA | `4513d577565cdec70c3bc747f947c30312d8e635a00de0d899cc7a39cfb27625` |
| RRËNJA MERKLE | `ff908387fa0a76615844b1eb2f3b6d25afb991cdfafb8197b5cbb8a7a203d8c9` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/0bb830ded3333b62dba7479bf422d34fcd1ed66c58d00d68558eb6f15262fca6`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

LIVE UPDATES ↘

2 ORE ME PARE
Njëri i çoi Agasit ekspertizën e makinës e tjetri i çonte ushqime/ GJKKO le në burg Embro Sulejmani dhe Fatjon Kalluçi! Pritet masa për ish-drejtoresën e SHISH

3 ORE ME PARE
Skandali i SHISH shkakton kaos në Kuvend/ PD kërkon debat me Ramën për SHISH, PS mbyll Parlamentin në mënyrë të njëanshme

4 ORE ME PARE
Jashtë protestë, brenda seancë plenare/ Shoqërohen disa persona, policia ngre gardhet metalike përreth Kuvendit

15 ORE ME PARE
EMRAT/ Plagosje me thikë në Tiranë, humb jetën 49-vjeçari, arrestohet autori

Politike

# "Agasi është mafiozi më i rrezikshëm i Evropës"/ Berisha: Vlora Hyseni ka zbatuar çdo porosi dhe urdhër të Ramës

Në fjalën e tij pas seancës plenare, Berisha tha se Hyseni, ka zbatuar porosi dhe urdhra të Ramës dhe se lidhjet e saj me Agasin kanë qenë të njohura në kryeministri dhe SHISH.

dosja
24 Shtator 2026, 13:55
Nga I.A



**TIRANË-** Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka akuzuar kryeministrin Edi Rama se ka pasur dijeni dhe përgjegjësi për veprimet e ish-drejtores së SHISH, Vlora Hyseni, ndërsa e cilësoi Ergys Agasin si mafiozin më të rrezikshëm të Evropës. Në fjalën e tij pas seancës plenare, Berisha tha se Hyseni, ka zbatuar porosi dhe urdhra të Ramës dhe se lidhjet e saj me Agasin kanë qenë të njohura në kryeministri dhe SHISH.

Ai akuzoi Hysenin se ka përdorur të dhëna sekrete të SHISH në funksion të një grupi të strukturuar kriminal, duke e cilësuar këtë si goditje për sigurinë kombëtare dhe besueshmërinë e Shqipërisë te partnerët ndërkombëtarë.

Berisha tha se Agasi kishte, sipas tij, kontroll mbi institucione të ndryshme të shtetit, ndërsa shtoi se përmes SHISH kishte akses te sekretet që NATO i ka besuar Shqipërisë. Më tej, ai përmendi edhe drejtues e zyrtarë të tjerë, duke pretenduar se veprimet e tyre janë kryer me dijeninë e kryeministrit Edi Rama.

*"Seanca e sotme është dëshmi tjetër flagrante se ky parlament përfaqëson krimin e organizuar, përfaqëson interesat më kriminale të Padrinos së vendit dhe nuk besoj se mund të gjendet një i dytë në planet që para një superskandali të rrallë në mbarë botën, bën avokatinë e regjimit, avokatinë e krimit dhe nuk shprehin as dhe qëndrimin më të vogël kritik. Natyrisht Edi Rama nuk është më kryeministri i Shqipërisë, por është Padrino i Shqipërisë. Faktohet në mënyrë përfundimtare si kreu i narkoshtetit të parë dhe të vetëm në Evropë. Me superskandalin e Vlora Hysenit, e emëruar jashtë çdo lloj kriteri në pozicionin më të rëndësishëm në raport me sigurinë kombëtare, e cila qëndroi aty si shërbëtore e dy zotërinjve, e Edi Ramës dhe Aleksandër Vuçiçit, u vu e tëra në shërbim të organizatës kriminale.*

editoriale

Eriseld Zeneli
Shqipëria, socializmi i Edi Ramës pa të majtën

Irena Beqiraj
Kostot e jetesës edhe lajmi se ekonomia po ecën mirë

Në vëmendje

AKTUALITET 24 SHTATOR 2026, 12:48
Shkoi në GJKKO për tu njohur me masën e sigurisë/ Momenti kur ish-drejtuesja e SHISH i kthehet gazetares: Si kalon ti me agjentët serbë në hotel (VIDEO)

POLITIKE 24 SHTATOR 2026, 12:10
Kryemadhi paraqitet në GJKKO, s'i kursen ironitë: Si s'na i fiku njeri radarët ne, vetëm na i ndezën!

*Nuk ka në historinë e shtetit shqiptar një akt më të rëndë, dhe e vërteta është që në çdo lloj analize në raport me sigurinë kombëtare, kjo përbën një akt madhor të asgjësimit të saj dhe të tradhtisë ndaj sigurisë kombëtare. Por, Vlora Hyseni ka zbatuar në çdo veprimtari të saj porositë, urdhrat e Edi Ramës. Lidhjet e saj me Ergys Agasin i ka ditur e gjithë kryeministria dhe SHISH. Nuk ka asnjë risi në ato lidhje. Por problemi është se përdorimi i të dhënave sekrete të SHISH në funksion të karteleve, në funksion të grupit të strukturuar kriminal, është goditje e tmerrshme për sigurinë kombëtare, për besueshmërinë e Shqipërisë tek partnerët ndërkombëtarë. Dhe duhet ta dini se në ato që janë marrëdhënie besimi, shërbimet inteligjente kanë një vend jashtëzakonisht të rëndësishëm.*

*Dhe absolutisht SHISH që nga themelimi gjer sot ka një trashëgimi shumë të çmuar bashkëpunimi me shërbimet më të mëdha të vendeve partnere, por edhe shërbime të vendeve të tjera dhe bashkëpunim të suksesshëm. Nuk ka lajm më të keq se sa lajmi se njeriu kryesor me të cilën ata bashkëpunonin ishte një kriminele që shiste sekretet e shtetit dhe shërbente si mburojë e anëtarëve të grupit të strukturuar kriminal. Por mes të gjithë anëtarëve dhe të gjithë emrave që ju mund të keni dëgjuar, Ergys Agasi është absolutisht mafiozi më i rrezikshëm i Evropës. Pse kjo? Se ky është i vetmi bos i krimit që kishte në kontroll të plotë, dhe unë e kisha denoncuar me kohë këtë, shërbimin informativ të shtetit.*
*Në kontroll të plotë ministrinë e rendit dhe policinë e shtetit. Në kontroll të plotë segmente të sistemit të drejtësisë. Ishte faktikisht zëdhënësi më i fuqishm i Padrinos së Shqipërisë.*

*Përveç kësaj, përmes SHISH, ai kontrollonte të gjitha sekretet që NATO i ka besuar Shqipërisë. Dhe akoma më shumë, ky grup i strukturuar kriminal kanë kontrolluar internetin dhe komunikimet me internet të shqiptarëve dhe të huajve në të gjithë territorin e Shqipërisë. Për të gjitha këto, Ergys Agasi është krimineli më i rrezikshëm që ekziston. Dhe ai kishte një shërbëtore, kishte nën urdhrat e tij kryetaren e SHISH. Në fakt, e them dhe njëherë, çdo veprim dhe akt i tyre, i Vlora Hysenit, i Ergys Agasit, i Ermal Beqirit, Karçanajt, drejtorit të përgjithshëm të policisë, Proda, etj, janë bërë absolutisht me urdhër dhe dijeni të plotë të Edi Ramës. Këta persona, në raste të caktuara, po flasin dhe do të flasin. Skandali, afera është e një rrezikshmërie të lartë dhe e përmasave tepër të mëdha. Asnjë reflektim.*

*A i patë deputetët? Jo më kot u thashë se janë deputetët e Kodrës së Kuajve. Gjatë gjithë fushatës elektorale, çdo dy-tre net, Ergys Agasi, klanet e Elbasanit, klanet e Durrësit, Vangjush Dako mblidheshin tek lokali që menaxhonte ky Embro Sulejmani, menaxher se pronar është dikush tjetër, edhe ai është i kësaj bote, dhe bënin projektin e grabitjes së mandateve. Ndaj dhe sot këtu, deputetët e Kodrës së Kuajve ishin deputetët më aktivë në mbrojtje të Ergys Agasit dhe Vlora Hysenit. Kjo e tëra dëshmon se Shqipëria është në krahët e krimit. Se PS është themeluar mbi krimin dhe vrasjet. Ka sunduar mbi krimin monstruoz të diktaturës komuniste dhe sundon sot mbi krimin, kartelet e drogës dhe vjedhjet e shqiptarëve,*" tha Berisha.**/Dosja.al**

sali berisha

## Sondazh

Poll

Politike

24 Shtator 2026, 13:51

# Berisha dënon shantazhin ndaj Klodiana Lalës: E kam thënë që gazetarët janë në përgjim


AKTUALITET 24 SHTATOR 2026, 11:25

Zbardhet dëshmia, ja çfarë deklaruan para GJKKO Embro Sulejmani dhe Fatjon Kalluçi: I çova ushqim, çfarë krimi kam bërë?

## më të klikuarat

“Krejt radarët e shtetit i mbyll për ty”/ Deklarata të forta dashurie nga Vlora Hyseni për Ergys Agasin: Të du!

Fati i Bleona Matës/ Nëna e saj ballafaqohet me avokatin Duraj: Po luan me ndjenjat e mia. Juristi: E kam të regjistruar

Dosja e SPAK/ Agasi mori të dhëna në telefonat e “zbërthyer” nga policia! Iu vunë në dispozicion nga përgjegjësi i Sektorit në Policinë Shkencore

I kërkuar nga SPAK për trafikimin e 50 tonëve kokainë/ Arrestohet në Rusi Shpëtim Aliu, një nga “kokat” e rrjetit të trafikut ndërkombëtar të drogës

## insights

Rezarta Gagani

Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?


## Moti

Powered by tomorrow.io

Sali Berisha TIRANË- Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, duke folur jashtë ambienteve të Kuvendit ka reaguar për sulmin ...

### Tensionet në Kuvend nuk ndalen, PS kalon direkt në votim projektligjet dhe mbyll Kuvendin

Politike

24 Shtator 2026, 13:18

### Koçeku: Rama të vijë në sallë dhe të thotë çfarë dinte, kreu i ri i SHISH të përgjigjet para deputetëve

Politike

24 Shtator 2026, 12:54

### Skandali i Vlora Hysenit/ Topalli-Peleshit: Je numri 2 i Republikës dhe nuk flet një fjalë për ish-shefen e SHISH! Të sugjeroj dorëheqjen

Politike

24 Shtator 2026, 12:42

### "Nuk është histori rozë kjo"/ Mesazhet mes Vlora Hysenit dhe Agasit, Korreshi: Kryeministrit duhet t'i themi që shtetit i kanë fikur radarët

Politike

24 Shtator 2026, 12:33

Politike

24 Shtator 2026, 12:10

## Kryemadhi paraqitet në GJKKO, s'i kursen ironitë: Si s'na i fiku njeri radarët ne, vetëm na i ndezën!

Monika Kryemadhi TIRANË- Ish-deputetja Monika Kryemadhi është paraqitur ditën e sotme GJKKO. Monika Kryemadhi ka ironizuar zhvillimet e...

### "Ia ka dorëzuar shtetin krimit të organizuar"/ Bardhi thirrje socialisteve

### në Kuvend: Silleni Ramen zvarrë ketu të japë llogari

Politike

24 Shtator 2026, 12:08

### Mungon Rudina Palloj/ Shtyhet sërish gjyqi për Ilir Metën dhe Monika Kryemadhin

Politike

24 Shtator 2026, 12:04

### Berisha-ministres Ismaili: Keni kaluar nga zyra e Ergysit? Të ka shërbyer ajo zyrë për t'u ngjitur si deputete?

Politike

24 Shtator 2026, 11:52

### "PS Parti e Skandaleve, jo më Parti Socialiste"/ Zhupa: Vlora Hyseni simbol i tradhtisë kombëtare!

Politike

24 Shtator 2026, 11:49

**MË SHUMË**




## Koçeku: Rama të vijë në sallë dhe të thotë çfarë dinte



Koçeku: Rama të vijë në sallë dhe të thotë çfarë dinte



Topalli-Peleshit: Je numri 2 i Republikës dhe nuk flet një fjalë për ish-shefen e SHISH!



Kryemadhi paraqitet në GJKKO, s'i kursen ironitë: Si s'na i fiku njeri radarët ne, vetëm na i ndezën



Mesazhet mes Vlora Hysenit dhe Agasit, Korreshi: Kryeministrit duhet t'i themi që shtetit i kanë…

Shiko video te tjera

KTHEHU NE KRYE

Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

**Drejtor: Enton Abilekaj**

**Kryeredaktor: Izmir Akulli**

**Gazetarë:**
Esmeralda Doçi
Emanuela Dida




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.